

Rregullorja e përgjithshme e punës

ILLYRIAN Eagle GmbH
Riethofstrase 4
8152 Glattbrugg
Schweiz
Drejtor Egzekutiv: Arben ZYBA
Nr. i firmës: CHE-357.256.320

1. Rregullat përgjithshme të ILLYRIAN Eagle GmbH

Të gjitha shërbimet e ILLYRIAN Eagle GmbH vlejné vetëm në bazë të kushteve të përgjithshme të biznesit në vijim. Përfundimet nga këto kushte të biznesit janë të vlefshme vetëm atëherë kur janë bërë si marrëveshje me shkrim dhe janë vërtetuar nga ne, po ashtu me shkrim.

2. Oferta dhe lidhja e kontratës

Ofertat për sistemin online të rezervimit paraqesin kërkesë të detyrueshme për klientin. Me regjistrimin përmes formularit online për rezervim, klienti lidhet detyrimisht gjatë përmbylljes së një kontratë për transport, me kushtet valide për transportim të ILLYRIAN Eagle GmbH. Me pranimin nga ana e ILLYRIAN Eagle GmbH, vjen deri te lidhja e kësaj kontrate për transportim. ILLYRIAN Eagle GmbH deklaron pranimin e rezervimit, në rastin kur e dërgon konfirmimin e rezervimit nëpërmjet një E-maili ose me ngarkimin e kartës tuaj të kreditit.

3. Kushtet e pagesës

Gjatë rezervimit vlejné çmimet, të cilat kanë qënë aktuale dhe janë të konfirmuar në mbylljen e rezervimit. Pagesa realizohet vetëm nëpërmjet një karte krediti të pranuar nga ILLYRIAN Eagle GmbH. Pas pranimit të konfirmimit të rezervimit, i gjithë çmimi i biletës duhet të paguhet, gjë që ndodh dhe me këtë ngarkohet xhirollogaria e kartës të kreditit të dhënë. Nëse banka ose instituti i kartave të kreditit e refuzon pagesën, ILLYRIAN Eagle GmbH është i autorizuar që ta ndërpresë menjëherë kontratën dhe që ta anulojë rezervimin.

4. Mbrojtja e privatesise

ILLYRIAN Eagle GmbH garanton mbrojtje privatesie të plotë për të gjitha të dhënat e pranuar nga klienti.

5. Dokumentet e udhëtimit

Pasagjeri merr nëpërmjet e-mailit konfirmimin e rezervimit të cilën e përdor edhe si bilete udhëtimi. Një udhëtim, pa dokument valid për udhëtim, nuk është i pranueshëm. Nëse të dhënat në biletë nuk janë të njëjta me të dhënat personale të pasagjerit të dhëna gjatë rezervimit, nuk mund të pranohen si dokumente valide të udhëtimit. Për përmbushjen dhe zbatimin e rregullave për hyrje në shtetet tjera, për pasaporta dhe për viza, secili pasagjer e mban përgjegjësinë mbi vete. ILLYRIAN Eagle GmbH është i autorizuar që pasagjerit t'ia llogarisë dhe t'ia vë në faturë çdo shpenzim eventual, që krijohet si pasojë e mospërmbushjes së këtyre rregullave.

6. Ndryshim rezervimi – Anulim

Ndryshim i datës të udhëtimit - Data e udhëtimit mund të ndryshohet nëse në fluturimin e dëshiruar ka vende të lira, poashtu pasagjeri ngarkohet me tarifen përkatëse.

Anulim (Storno)- Pasagjeri ka te drejte te terhiqet nga fluturimi ne cdo kohe, nese fluturimi i rezervuar anulohet keto jane tarifat per anulim: Deri në 7-të dite para nisjes 25% të çmimit të fluturimit, Prej 6-të dite deri 48 orë para nisjes 50% e çmimit të fluturimit, Nga 48 orë në 0 orë para nisjes 100% të çmimit të fluturimit. Për anulime në ditën e fluturimit, llogaritet çmimi i

tërësishëm i biletës (100% i çmimit të biletës).Për mosparaqitje në udhëtim (Non Show) llogaritet i tërë çmimi i biletës

7. Koha për Regjistrim (Check-in)

ILLYRIAN Eagle GmbH i këshillon pasagjerët që të paraqiten tek sporteli përkatës të paktën 3 orë para nisjes së fluturimit. Check-in mbyllet 45 minuta para nisjes së fluturimit. ILLYRIAN Eagle GmbH nuk mban përgjegjësi për paraqitje me vonesë në Check-in. Pasagjeri është vetë përgjegjës për paraqitjen e tij me vonesë në Boarding (hyrja në aeroplan).

8. Ndryshim i orarit të fluturimit:

ILLYRIAN Eagle GmbH është i detyruar që klientët e vetë ti lajmërojë për çdo ndryshim të orarit të fluturimit me anë të telefonit ose e-mail adreseë që është regjistruar në rezervimin e tyre. Gjithashtu klientët janë gjithmonë të mirëpritur për pyetjet e tyre para fluturimit.

9. Bagazhi

Pagesa e bagazhit është 23 kg për pasagjerin që paguan. Nuk është e mundur të bartni bagazhet e papërdorura tek pasagjerët e tjerë. Bagazhi i tepërt transportohet kundrejt pagesës së tarifave të tepërt të bagazhit të aplikueshëm. Asnjë bagazh i tepërt nuk mund të garantohet.

10. Dokumentacioni për udhëtim

Personave që ju ka skaduar data valide në dokumentin për udhëtim gjegjësisht Pasaportës duhet që nga organet përkatëse në rastin konkret Ambasadës të shtetit nga ku ato vijnë, të pajisen me një letër udhëtimi. Foshnjat të lindura në një vend të huaj që nuk posedojnë nënshtetësinë e vendbanimit aktual prindërit janë të detyruar që në Ambasadën përkatëse të pajisen me një letër udhëtimi.

11. Reklamimet-Pakënaqësitë

Reklamimet mund të bëhen në mënyrë të shkruar menjëherë pas përfundimit të fluturimit tek adresa e poshtëshënuar:

ILLYRIAN Eagle GmbH
Riethofstrasse 4
8152 Glattbrugg
E-Mail: info@illyrianeagle.ch
Tel: +4144 500 64 44

12. Vendi i arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit është Zürich.

13. Klauzola salvatoriane

Në qoftë se klauzola të veçanta të rregulloreve të dala janë tërësisht apo pjesërisht të paefektshme, atëherë validiteti i rregulloreve të tjera mbetet i paprekur nga kjo. Rregullorja e paefektshme zëvendësohet me një rregullore e cila për nga qëllimi dhe kuptimi i rregullores së paefektshme është më e përafërt juridikisht dhe ekonomikisht.

14. Qëndrimi

Këto kushte i përkasin qëndrimit të datës 27.07.2022.